

FATOS KONGOLI
TE PORTA E SHËN PJETRIT
R O M A N

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

TE PORTA E SHËN PJETRIT

ROMAN

botimi i pestë

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2010

Botimi i parë : 10 shkurt 2005
Botimi i dytë : 21 shkurt 2005
Botimi i tretë : 10 maj 2005
Botimi i katërt : dhjetor 2006
Botimi i pestë : korrik 2010

Botues: Fatmir Toçi
Përkujdesja grafike: Mereme Nelaj
Përgatiti për shtyp dhe kopertina: Irena Toçi
Në kopertinë: Fragment nga piktura "Vajza që pastron pleshtat"
e Giuseppe Maria Crespi

© Autori dhe Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollësja", K.Postare 1420, Tiranë
Tel.: (355) (4) 240116; 240117; 258893
Tel./Fax: (355) (4) 240117
E-mail: toena@toena.com.al; info@toena.com.al
Http://www.toena.com.al

*Gjithçka në këtë libër është trillim i fantazisë.
Çdo ngjashmëri me ngjarje, mjedise dhe
persona realë është krejt e rastit.*

Autori

1.

Ai sapo ishte futur në ujin e ngrohtë të vaskës, me kokën të rëndë, kur u çlirua sinjali i telefonit të tij celular: motivi i Simfonisë së pestë të Beethoven-it. Numrin e telefonit të tij celular e dinin shumë pak njerëz. Ai e kishte ndërruar përpara nja dy javësh, kësaj radhe për të tretën herë, duke ruajtur sinjalin. Askush nga rrethi i tij i afërt nuk habitej më që ai s'duronte gjatë pa e ndërruar numrin e celularit. Që, në çdo rast, sa herë kryente ndërrimin, ruante të njëjtin motiv për sinjalin, motivin e Fatit, e këtë e lidhnin me thelbin supersticioz të natyrës së tij. Ishte bërë i njohur tashmë nervozizmi që e pushtonte kur vinte re se numrin e celularit ia dinin edhe persona përtej rrethit të ngushtë, ndonëse ky dekonspirim, siç e quante, nuk mund t'i prishte kurrfarë pune. Ai nuk ishte ministër, as kryeministër. Ishte thjesht një profesor historie që botonte ndonjë artikull

në shtypin e përditshëm dhe ftohej më të rrallë të shfaqte mendime për ngjarje historike në ndonjë kanal televiziv. Kështu që mania e kohëve të fundit për ta ndërruar numrin e celularit aq shpesh pa ndonjë arsye, ishte pranuar si një lloj sëmundjeje e tij e panjohur deri atëherë dhe burri nuk e fshihte pakënaqësinë që e keqja i vinte nga ndonjëri apo ndonjëra e rrethit të njerëzve më të afërt: me gjithë porositë e tij, të thuash se ia bënin qëllimisht, ata ia nxirrnin të fshehtën.

Ai u zhyt edhe më në ujë. U mbulua nga shkuma dhe mbylli sytë. Motivi i Simfonisë së pestë shkëputej nga celulari, të cilin e kishte lënë aty pranë, mbi një ndenjësë plastmase, përshkonte hapësirën e vogël që i ndante, mbërrinte në timpanin e veshëve të tij dhe ai u zhyt i tëri në ujë pa lënë jashtë as majën e hundës, as cepin e ndonjë veshi. E mbajti frymën për disa çaste, i mbështjellë nga një shurdhëri e lagësht, gjithnjë me kokën të rëndë, duke ndier rrahjet e zemrës, duke ndier edhe rrahjet e tëmthit, derisa nuk duroi dot më. Po të vazhdonte të rrinte i zhytur në ujë rrezik t'i shpërthenin edhe zemra, edhe damari i tëmthit. Nxori kokën në sipërfaqe, mbi shkumë, u mbush me frymë dhe hapi sytë. Atëherë e kuptoi se personi që e kërkonte në atë orë të mëngjesit vazhdonte të këmbëngulte i bindur se ai do t'i dorëzohej tundimit për të marrë vesh së paku se kush e kërkonte. Në këtë pikë, tjetri ose tjetra gabohej.

Meqë numrin e kishte ndërruar vetëm prej dy javësh dhe atë e dinin pak njerëz, ai e merrte me mend se kush po orvatej të lidhej me të. Duhej të ishte pikërisht ndonjëri prej tyre. Ai nuk kishte

dëshirë të fliste me asnjërin prej tyre. Ai kishte vetëm një dëshirë, jo fort serioze për një profesor universiteti: të tallej. Ndryshe, po të mos donte vërtet ta shqetësonin, e bllokonte celularin. Dhe nuk e merrte në banjë. Dhe nuk e linte pranë vetes, mbi ndenjësën prej plastmase, për të dëgjuar se dikush shumë i afërt do ta kërkonte në telefon. E para në listën e këtyre njerëzve shumë të afërt renditej bashkëshortja e tij, një bionde imponante, autore e disa librave, të suksesshëm sidomos në mjediset femërore. Ai nuk donte t'i përgjigjej. Ai donte vetëm t'i ngacmonte nervat duke mos iu përgjigjur.

Për arsye që i kishte dhe nuk i kishte të qarta, fjala afërsi në marrëdhëniet me të shoqen nuk e përmbante më kuptimin real, ndonëse ata vazhdonin të ndanin të njëjtin shtrat. Ai shihte të hapej midis tyre një largësi, e cila prej vitesh zmadhohej në mënyrë dramatike, aq sa më në fund idea e një divorci e kishte shkundur si një rrufe në qiell të hapur. Kjo ide i kishte shkrepur në tru për herë të parë një natë, pas kthimit në shtëpi nga një darkë, që miku i tij Angjelin Kalaja, inxhinier arkitekt, anëtar i bordit drejtues të kompanisë së ndërtimit “Kuartet”, një burrë rreth të dyzetave, një dy-tre vjet më i ri se ai, shtronte me rastin e ditëlindjes së të birit, ku ai mori pjesë me të shoqen me statusin e të ftuarit të nderit: dhjetë vjet të shkuara kishte pranuar të bëhej nun i atij djali.

Kronika e dramës së tij të asaj nate përmbledhet si vijon: gjysmë i dehur, duke e dëshiruar të shoqen marrëzisht, ai provoi ta mbyllte festën, siç ishte e natyrshme për shkak të ndezjes nga alkooli, me një shkarkim seksual, çka nuk ndodhi. Me t'u futur në shtrat, e shoqja e kundërshtoi vendosmërisht dhe,

i lënduar rëndshëm, ai u detyrua të hiqte dorë. Tek rrinte shtrirë i zhveshur krejt pranë trupit të bashkëshortes, që i kishte kthyer shpinën, iu kujtua se ky nuk ishte rasti i parë që ajo i shmangej. Ajo i ishte shmangur plot herë të tjera. Ai u përpoq t'i gjente sjelljes së saj një shpjegim dhe, meqë nuk gjeti, e mbyti dyshimi poshtërues se ndoshta ajo e tradhtonte, pandehmë e hershme që zakonisht ai e ndrydhte përbrenda, duke e kaluar gjithçka në heshtje. Mirëpo atë natë sa më shumë bluante me vete i fyer në sedrën e tij mashkullore, aq më shumë e humbiste arsyen, derisa mbërriti në përfundimin se marrëdhënia e tyre nuk mund të vazhdonte kështu. Po të ma bëjë këtë edhe një herë tjetër, mendoi i errur, do t'i kërkoj divorcin.

Trimëri e kotë. Në një rast të tillë ajo do të shqyente sytë. Platon, do t'i thoshte e habitur, mos flit marrëzira, nuk më pëlqejnë as në formë shakaje. Dhe, po të ndodhej në një humor jo dhe aq pozitiv, reagimi i saj do të ishte më kategorik. Zoti Platon Guri, do t'i thoshte e zemëruar, një burrë mund të bëhet qesharak në një mijë mënyra. Nga këto një mijë mënyra, ti ke zgjedhur më të keqen, sepse atë që po më thua nuk e beson as vetë.

Sigurisht, mërmëriti burri sikur e shoqja të ishte aty pranë, në anë të vaskës, ulur te ndenjësja prej plastmase ku ndodhej celulari, ke të drejtë. Dhe, pa vetëdijë, nën ujë, dora i vajti te seksi. Atë çast motivi i Fatit u ndërpre dhe ai u krodh përsëri në një shurdhëri të ngrohtë. Pa e kuptuar se si, seksi iu fry. Ai e shtrëngoi i pështjelluar. Në ato rrethana fryrja e seksit iu duk absurde. Mbeti një copë herë

me seksin në dorë i zhytur brenda vaskës si një send pa vlerë, nën pushtetin e absurdit të tij të padepërtueshëm, që fryhej idiotësisht.

E përfytyroj, vazhdoi të fliste me sytë mbyllur, pa e lëshuar seksin, je bërë nevrike. Gjithë këto ditë ke pritur të të telefonoj, ndërsa unë jo vetëm nuk të kam telefonuar, por nuk kam marrë mundimin as t'u përgjigjem thirrjeve të tua. Nuk e besoj të jesh bërë merak për shëndetin tim: më duket se vuaj nga tensioni. Kam dhimbje koke, turbullirë dhe këputje të këmbëve. Çdo mëngjes dal nga shtëpia me mendimin të kthehem nga ambulanca e lagjes. Së paku të marr vesh në kam apo nuk kam tension. Mirëpo një ditë që m'u mbush mendja të kthehesha andej, gjeta aq shumë njerëz në radhë, sa vura majat nga thembrat. Mora vesh pastaj se edhe po të kisha qëndruar në radhë nuk do të mbaroja punë, u dashkej libreza shëndetësore. Unë nuk e di të jem i pajisur me librezë shëndetësore. Di gjë ti?

Mos më mbush me miza, do të thuash, ku kërkon të dalësh? Përsëri ke të drejtë, gjithmonë ke pasur të drejtë. Unë asnjëherë nuk e kam ditur ku dua të dal, siç nuk e di edhe tani, i zhytur në vaskë, me kokën të rëndë dhe, ta pohoj çiltërsisht, me seksin të fryrë. Idiotësisht. Sepse në këto çaste ndihem krejt impotent dhe, mos të të mbetet hatri, unë e di që nuk të mbetet hatri, në këto çaste je e fundit që do të doja ta kisha pranë. Nuk të dëshiroj, e dashur, megjithëse prej disa ditësh trupat tanë ndodhen tepër larg njëri-tjetrit dhe në largësi, me ç'kam vënë re, trupat ngarkohen me potenciale dëshirash. Trupi im këto ditë nuk është ngarkuar me ndonjë

potencial për ty. Këto ditë të mungesës sate, kur ti gjendeshe tepër larg meje edhe në pikëpamje fizike, diçka e tillë ka qenë e pamundur. Ndodhi ajo që kujtoja se nuk do të ndodhte kurrë, që e realizoja vetëm me fantazi. E dashur, për herë të parë në jetën time të kam tradhtuar. Jo me mend, siç kam bërë shpesh. Të kam tradhtuar realisht, me një femër tjetër.

Burri heshti për një çast. Pa e lëshuar seksin nga dora. Po ta lëshonte, do të ndihej i çarmatosur, i vetëm para së shoqes, dhe i vetëm para saj ai e humbiste.

Tani që e bëra këtë pohim, mori zemër, ndihem më i qetë, megjithëse koka më dhemb. Siç të thashë, është tensioni. Ai tension i mallkuar që unë e shpërfill dhe ndonjë ditë do të më hajë kokën. Dhe ku ta gjesh të të hajë kokën, ndryshe rrezik të të lërë për gjithë pjesën e mbetur të jetës sakat. Më fal, singërisht, po flas kodra pas bregut. Nuk e kuptoj përse tani që sapo të pohova tradhtinë time reale e ti ndoshta pret ndonjë shpjegim, unë po ta mërzis shpirtin me dokrra si tensioni im i supozuar. Më mundon një parandjenjë, seç kam një frikë. Sikur sot do të ndodhë shpërthimi hipertensiv brenda kafkës sime... Mirë, pra, po e teproj. Puna është më e thjeshtë. Ditët e fundit kanë qenë për mua shumë të ngarkuara. Me pije dhe gjëra të tjera. Kështu që është e natyrshme të vuaj nga kjo dhimbje koke e poshtër. Dhe tani që aventura u mbyll papritur, - ç'është më e bukura, për faqe të zezë, - dua të t'i tregoj të gjitha, pa të mbajtur asnjë të fshehtë.

Jo, qëllimi im nuk është të të lëndoj, nëse ti mund të lëndohesh prej meje. Do të ishte e pabesueshme për mua, një surprizë. Nëse ti lëndohesh prej meje, do të thotë se gjatë viteve të jetës sonë të përbashkët unë nuk kam kuptuar asgjë, pra duhet të rivlerësoj qëndrimet e mia. Të rivlerësoj vetveten. Mirëpo kjo do të ishte e panevojshme. Për honet e errëta të përbuzjes së heshtur midis nesh, fajtori jam unë, e pranoj. Unë nuk kam pasur guxim t'i shoh me urtësi disa të vërteta. E vërteta e parë: duhej të të kisha larguar prej kohësh nga jeta ime. Ose, thënë më drejt, duhej të kisha pasur burrërinë të largohesha nga jeta jote prej kohësh. Nuk e kam bërë këtë. Na del se dashuria e nënshtruar qenka dobësia më e rrezikshme.

Tradhtia ime nuk është e rastit, një aksident në kushtet e mungesës sate. Madje fjalën tradhti unë po e përdor për forcë zakoni, kështu është pranuar të quhet brez pas brezi veprimi i kryer prej meje. Do të kisha dëshirë të flisja gjatë me ty për këtë, të di mendimin tënd. Të di gjithashtu nëse ti, nga ana jote, e pranon apo jo përdorimin e fjalës tradhti në një rast të tillë. Tekefundit, më fal që po marr guximin të të pyes, a je ndier ndonjëherë sado pak edhe ti tradhtare ndaj meje dhe, besoj, e kupton çfarë dua të them. Megjithëse kjo është një pyetje prej idioti. Përgjigja e saj mund të gjendet te librat e tu. Mjafton t'i lexosh. Por, siç thua ti, nuk duhet të tregohem injorant, ta ul veten në shkallën e lexuesit naiv, i cili kërkon autorin pas gjithë personazheve të tij. Sigurisht, e dashur, unë nuk kam menduar se pas grave të romaneve të tu, je ti. Pra, nuk do ta mësoj kurrë nëse je ndier ndonjëherë tradhtare

ndaj meje. As dua ta mësoj. Edhe sikur të ta drejtoja këtë pyetje, do të pendohesha. Sepse, siç mund ta marrësh me mend, unë kam dyshuar ndaj teje, ama vetëm kaq. Ideja e ballafaqimit me fakte të mundshme, ka qenë për mua poshtëruese. E hapa këtë parantezë që ti të bindesh se në këtë ekzistencë jo aq të lavdishme kam pasur shumë herë tundimin dhe mundësinë të konsumoja, po të më lejosh të flas me gjuhën e juristëve, atë që quhet akt i tradhëtisë bashkëshortore. Nuk e kam konsumuar. Sepse unë kam pasur gjithmonë një mendim të prerë për këtë, mendimin që e jep vetë fjala tradhti.

Nuk po kupton gjë, kështu? Këto të duken përçartje. Dhe je gati të më quash psikopat. Mund të më quash me çdo lloj epiteti, ndjeshmëria ime është zero. Vetëm seksi im i fryrë idiotësisht më kujton se vazhdoj të jetoj për inerci në një botë që për mua e ka humbur domethënien. Do të më duhet një kohë shumë e gjatë ta marr veten. Madje kjo është e dyshimtë. Megjithëse seksi im qëndron i fryrë idiotësisht, këmbëngul të më mbushë mendjen se jeta ndjek logjikën e tij dhe jo logjikën time prej psikopati, pas asaj që më ndodhi unë nuk e di nëse do të arrij ta marr veten ndonjëherë. Sepse mua më ka ndodhur diçka, e dashur. Nuk e kam fjalën për atë që e quajnë tradhti e që unë më në fund e konsumova pa u penduar dhe pa ndonjë ndjenjë fajësie. Më ka ndodhur diçka e rëndë, shumë e rëndë!

Mos u ngut të nxjerrësh përfundime. Mendërisht jam i kthjellët, pavarësisht turbullirës në kokë. Qëllimi im nuk është të tregoj aventurën time. Po të mos ndodhte ajo që ndodhi, unë as do ta merrja

mundimin ta bëja këtë rrëfim për një histori ku nuk ka asgjë të veçantë. Një lajthitje kalimtare, për të thyer monotoninë e ekzistencës, ndonëse në rastin tim puna qëndron ndryshe, nuk është as lajthitje, as kalimtare. Unë, siç thuhet, kisha predispozitë për diçka të tillë. Mua më mungonte vullneti për të vepruar, por jo dëshira. Dhe sapo u krijuan kushtet e përshtatshme, kur nga unë kërkohet pjesëmarrja, nuk ngurrova.

Të vijmë tani te ato që i quajta kushte të përshtatshme. Gjithçka nisi rastësisht verën që shkoi, më saktë në ditët e para të qershorit. Duke qenë se tani sapo ka hyrë java e tretë e janarit, do të thotë se qysh atëherë kanë kaluar nja shtatë muaj. Besoj e ke parasysh atë bar-kafenë në radhën e lokaleve të kryqëzimi i rrugës pranë Bankës Amerikane, ku ne jemi ulur një herë, një mbrëmje, dhe ty nuk të pëlqeu. Kërkove të largoheshim prej andej sapo zumë vend, the se aty pihej shumë duhan, se nuk i duroje dot zhurmat, e në këtë pikë kishe të drejtë, ishim ulur në verandë dhe boritë e makinave të ngacmonin nervat. Ta themi midis nesh: unë pata përshtypjen sikur ti u largove më shumë për një arsye tjetër. Ti nuk u ndjeve mirë në praninë e një morie çupëlinash që mbushnin lokalin. Sado e bukur dhe e mbajtur, ti nuk mund t'i bëje dot ballë konkurrencës së tyre, ato të sfidonin dhimbshëm me rininë agresive dhe ti nuk e ke për natyrë ta shohësh veten të mundur. Por kjo është vetëm një hamendje, pa asnjë qëllim të keq ndaj teje. Ato çupëlina agresive po të kishin moshën tënde s'do të të vinin as te kyçi i këmbës... Pra, kushtet

e përshtatshme, që përmenda, nisën pikërisht atje. Edhe atëherë, ashtu si tani, ti ndodheshe jashtë shtetit, por jo te vajza në Gjermani. Atëherë ti ishe në Zvicër me shkrimtarin P.M. Gjatë asaj jave, kur ti ndodheshe në Zvicër në shoqërinë e zotit P.M., unë kam vuajtur shumë... Jo, nuk është nevoja të më kundërshtosh, njeriu nuk e ka në dorë të bëhet a të mos bëhet xheloz.

Atë mbrëmje të nxehtë, për gati një orë unë u përpoqa të lidhesha me ty. Më kot. Ti e kishe bllokuar celularin. Nuk ia vlen të të përshkruaj skenat që më mundonin. Pastaj, edhe sikur ti të më përgjigjeshe, thelbi i çështjes nuk do të ndryshonte. E kisha të pamundur t'u shpëtoja atyre skenave, derisa nuk durova dot më. Po të vazhdoja të rrija i mbyllur brenda, pre i vegullive të mia, do të luaja mendsh. Vendosa të dilja, pa e ditur se ku do të shkoja. Zbrita poshtë, nxora makinën nga garazhi. Bëra një dy-tri xhiro kot, nëpër qendër, nga stacioni i trenit, te korpusi i inxhinierisë. Pastaj mezi gjeta një vend për të parkuar makinën diku, në anën e poshtme të rrugës që kalon përpara Bankës Amerikane. Dhe këmbët më çuan te lokali ku ishim ulur bashkë e ty s'të pëlqeu. Kisha dëgjuar të flitej se në atë zonë ndodhnin edhe gjëra të dyshimta, fjala vjen, shpërndahej drogë. Mund të gjendeshin edhe prostituta. Droga nuk më interesonte. Prostitutat po. Atë mbrëmje unë do ta kisha marrë ndonjë nga ato mjerane të kaloja me të natën në ndonjë motel jashtë qytetit, ndonëse nuk kisha idenë se si mund të hyja në kontakt. Nuk hasa ndonjë të tillë. Nëse ekzistonin, ato s'i gjeje rrugëve, aq më pak në barkafenë te kryqëzimi pranë Bankës Amerikane. Në

vend të tyre atje m'u shfaq dikush tjetër: miku ynë Angjelin Kalaja.

Një herë, e kishe tepruar me verë të kuqe apo s'di se si, ti e cilësove atë Angjelin Kurvari. Pa ndonjë ngarkesë negative. Ky cilësim të doli hareshëm, si një lëvdatë dhe shpesh kam menduar se njeriu i përshtatshëm i jetës sate duhej të ishte një mashkull i tipit të Angjelinit. Por kjo, sigurisht, s'ka kuptim. Angjelini pra, ndodhej në atë lokal, ulur në një nga tryezat e verandës, mbushur plot. I hutuar siç isha, duke i vështruar me synimin tim të mbrapshtë vajzat e shumta që shkonin e vinin në atë orë të mbrëmjes, unë nuk e vura re. Me vuri re ai. Dhe më thirri. Nuk ishte vetëm. As në shoqërinë e Valit, bashkëshortes së tij dhe mikeshës sonë. Ishte në shoqërinë e dy femrave të panjohura për mua.

Kur ai më thirri, më ftoi të ulesha në tryezën e tyre, unë u zura në befasi. Desha të shtiresha, të bëja sikur s'kisha dëgjuar gjë. Të vazhdoja rrugën e të largohesha, aq të pamundur e kisha të duroja cilindo, qoftë dhe Angjelinin. Por një gomarllëk të tillë ai s'do ta hante kështu që ktheva rrugë dhe ngjita shkallët e verandës. Nervat e mia u ngacmuan në skaj kur Angjelini gjeti mënyrën më të keqe për të më paraqitur te shoqërueset e tij. Zotëria, u tha, është miku im i ngushtë Platon Guri, profesor i nderuar dhe bashkëshort i një gruaje po aq të nderuar, në mos ca më shumë. Meqë jeni femra të emancipuara nuk ka si të mos e njihni shkrimtaren Adriana Gjini. Mospërputhja e mbiemrit nuk duhet t'ju habisë.

Gëlltita vështirësisht fjalën “idiot”, që më erdhi në majë të gjuhës. Pa e çuar nëpërmend se pikërisht

kjo lloj idiotësie euforike e Angjelinit do të ngjallte një interes të papritur për mua të dyja femrat. Me këtë rast, e dashur, jam i shtrënguar të të bëj të ditur një tjetër paradoks: në gjithë këtë histori emri yt luajti rol vendimtar: në sytë e mikeshave të Angjelinit unë u bëra interesant vetëm si bashkëshorti yt. Dhe jo aq si bashkëshort i një shkrimtareje, se sa i një gruaje të bukur. Si grua, ti duhet ta kuptosh mirë përse bashkëshorti i një femre të bukur bëhet tërheqës në sytë e femrave të tjera. Kjo nuk më kishte vajtur nëpër mend dhe as tani nuk arrij ta kuptoj. A ma shpjegon dot ti?

E shoh, po këpus dokrra. Nga ato që ty të ngrejne nervat. E të ngjallin përçmim. Nuk është nevoja të më përçmosh. As ti, askush tjetër nuk mund të më përçmojë aq sa e përçmoj unë veten. Sapo e vura re përshtypjen që bëri fakti i të qenit bashkëshorti yt, pra i një gruaje të bukur, që duket edhe më e bukur në intervistat televizive, thashë me vete pse jo, pse të mos luaj pak. Tekefundit, ç'të keqe ka të përfitoj disi nga fama letraro-televizive e bashkëshortes sime, e cila tani ka bllokuar celularin, çka do të thotë se nuk pranon të shqetësohet nga askush, aq më pak nga një qenie e rëndomtë si bashkëshorti, mashkulli që të njeh ligji, me të cilin duhet të ndash shtratin çdo natë, t'i durosh erërat e trupit, me raste edhe ndonjë erë tjetër, që gjithsesi quhet erë... Pra, vura të gjitha forcat të dukësia sa më i këndshëm dhe, i habitur, zbulova një të vërtetë: nuk e kisha humbur aftësinë për të komunikuar me femrat. Këtë ma pohoi edhe Angjelini. S'të kisha parë prej vitesh kaq në formë, tha ai kur dy femrat, kolege të tij në kompaninë e ndërtimit, u larguan dhe ne

mbetëm të dy, e vazhduam të qëndronim edhe një orë tjetër duke pirë konjak “Napoleon”. Ato u larguan pasi kishin zënë vend në një veturë të tipit “Smart”, parkuar shumë pranë lokalit, në trotuarin e anës tjetër të rrugës dhe një copë herë unë dhe Angjelini vështruam njëri-tjetrin, derisa unë vendosa t’i bëja një pyetje të drejtpërdrejtë. Që ti shkon me njërën prej tyre, e kam të qartë. Dua të di me cilën shkon, i thashë. Angjelini qeshi. Angjelini ishte në formë dhe nuk dredhoi. Ai vetëm kërkoi ta gjeja unë vetë. Iu përgjigja pa u menduar fare. Ti shkon me atë të renë, i thashë, me atë që e quanin Entela dhe zuri vend në timonin e veturës. Ai u zgërdhi. Tjetra sapo është ndarë nga i shoqi, ma ktheu. E kapa menjëherë nëntekstin e kësaj përgjigjeje. Besoj se tani edhe ti po fillon të kuptosh diçka. Është fjala pikërisht për gruan me të cilën të kam tradhtuar.

Mos u bëj merak, të siguroj: unë nuk kam fjetur me të në shtëpi, dua të them në shtratin tonë bashkëshortor. Pra, kur të kthehesh, do ta gjesh integritetin e shtratit të pacenuar. Po ta ftoja në shtëpi gjatë këtij dhjetëditëshi të mungesës sate, fqinjët tanë kureshtarë rrezik ta vinin re dhe nuk do të më pëlqente që, në këtë pikëpamje, ata të hidhnin mbi mua edhe hijen më të vogël të dyshimit. Pohim i palavdishëm ky. Për të mos thënë i dhjerë. Tërë kohën mendja ime punonte me ethet e një adoleshenti variante që do të mundësonin të flija me të. Sepse, në të vërtetë, deri para dy ditësh unë ende nuk kisha fjetur me të. Dhe besoj se, pasi fjeta një herë të vetme, nuk do të fle më, ndonëse ky fakt nuk mund të jetë ngushëllues për ty. Ti s’ke

nevojë të ngushëllohesh për një veprim timin që, po ta marrësh vesh, nuk do të të trondisë edhe aq. Ndërsa unë, po të kisha një grimë burrërie, tani, në vend që të rrija shtrirë në ujin e ngrohtë të vaskës duke shtrënguar seksin tim të fryrë idiotësisht, do t'ia këpusja vetes. Nuk e bëj dot. Gjithë jetën time kam qenë frikacak, pa e ditur, ndoshta pa dashur ta pranoj se jam i tillë. Ti, mesa duket, e ke vënë re prej kohësh, e ke ditur gjithmonë dhe më ke ndëshkuar në mënyrën tënde. Më në fund e kam kuptuar, e dashur: një grua mund t'i falë një burri gjithçka, por jo frikën.

T'i lemë hipokrizitë, nuk po të flas për cenet e mia të njohura. Unë vazhdimisht e kam ndier veten keq që, për shembull, natën, sidomos kur fle në shpinë, gërhas. Që jam leshator e kjo ty nuk të pëlqen. Që qafën e kam pak të trashë, pra jo aq elegante, në përputhje me shijet e tua. Që, tekefundit, seksi im, në gjendje të fryrë, mezi i arrin gjashtëmbëdhjetë centimetrat e ndoshta ti do të kishe dashur më shumë, një seks më të madh, megjithëse një bisedë lidhur me madhësinë optimale të seksit mashkullor nuk është bërë kurrë midis nesh. Të gjitha këto, e cene të tjera si këto, shpesh më kanë bërë të vuaja. Mirëpo tani nuk kam parasysh asnjërin prej tyre. Askush në faqe të dheut nuk është pa cene, për rrjedhojë as unë dhe mendoj se m'i ke falur, siç t'i kam falur edhe unë të tuat, pa dashur të t'i përmend. Ti nuk më ke falur vetëm një cen: frikën. Më në fund, disi me vonesë, e kam kuptuar këtë, por siç thuhet, më mirë vonë se kurrë. Dhe, sado e pabesueshme të duket, shkak i këtij ndriçimi tim të vonuar u bë tradhtia ime.

Po, e kuptoj padurimin tënd, të kërkoj ndjesë. Në rrjedhën fatale të tradhtisë sime, ndonjë hollësi ka të ngjarë të të fyejë. Prandaj e shoh të nevojshme të ve në dukje një rrethanë: e dashur, ti je më e bukur. Dhe, pa dyshim, më e stërholluar. Tradhtia ime nuk ka lidhje me ndonjë venitje të hireve të tua. Por meqë dokrra të tilla ty të ngrenë nervat, po hyj në temë.

E quajnë Roksana. Nuk të gënjej. Dhe s'dua të t'i ngre nervat më keq. Ajo vërtet mban emrin e gruas së Aleksandrit të Madh që, sipas legjendës, kur u gjend përpara saj, pësoi atë që francezët e quajnë "coup de foudre". U ndodha atje rastësisht, në kërkim të ndonjë prostitute. I kisha mbushur mendjen vetes se po të mos e kaloja natën me ndonjë prostitutë do të luaja mendsh dhe papritur Angjelini më paraqet një grua të re me emrin legjendar Roksana. Që rastësisht është edhe emri i personazhit më të bukur të romaneve të tu. Bashkëfajësia jonë duhet të ketë lindur pikërisht në çastin kur Angjelini më paraqiti si burrin tënd ndërsa unë tek ajo të pashë ty.

Po të pohoj një të fshehtë, e dashur. Pak më sipër të gënjeva. Lidhur me gratë e librave të tu, e vërteta është ndryshe. Më fal, por unë kam qenë gjithmonë i bindur se historitë dashurore të Roksanës sate, janë historitë e tua. Atë libër e kam lexuar disa herë. I di përmendësh të gjitha skenat erotike. E në çdo skenë të shoh ty. Se si vuan, si rënkon, si e mbyl klithmën shumë të njohur për mua të çastit të orgazmës. Dhe një mijë hollësira të tjera. Te të gjitha personazhet e tua femra unë të shoh ty. Përkundrazi, veten nuk e shoh qoftë dhe së largu te meshkujt me të cilët ato flirtojnë. Për dreq, më

duket sikur tipare të miat i gjej te ca burra hije. Ca dordolecë që gati i shtyjnë me përdhunë gratë e tyre në krahët e meshkujve të tjerë. Kështu që pas këtij rrëfimi të pjerdhur, shpresoj ta kuptosh përse, kur unë u gjenda përballë koleges së mikut tonë të përbashkët, me emrin Roksana, nuk pësova ndonjë “coup de foudre”. Unë thjesht u hutova. Ti ndodheshe larg, në Zvicër, në shoqërinë e zotit P.M., vetëm për vetëm. Dhe celularin e mbaje të mbyllur.

Po pse dreqin t’i rrëfej këto? Nesër ti do të kthehesh, unë do të dal në aeroport, të të pres, të dy do të përpiqemi të shtiremi të përmallur, në mbrëmje do të ndajmë së bashku shtratin bashkëshortor. Do të rrimë pranë njëri-tjetrit në heshtje. Nëse unë, për mirësjellje do të orvatem, ti do të ankohesh, do të thuash se ndihesh e lodhur. Mos ki frikë, e dashur. S’do të ndodhë kështu. Unë nuk të dëshiroj më.

Në këtë pikë rrjedha e arsytimit iu ndërpre. Dora që mbante seksin iu var, siç iu var seksi. Ai u ndie tmerrësisht i lodhur. Dhe do ta kishte zënë gjumi brenda në vaskë sikur të mos ishte çliruar motivi i Simfonisë së pestë të Beethoven-it.

Lëvizi ngathtësisht. Qëndroi një copë herë me shpresë se, ashtu si pak më parë, tjetri ose tjetra do ta humbiste durimin. Më kot: tingujt e celularit përshkonin hapësirën e vogël që i ndante me një këmbëngulje dramatike. Ai u ngrit. Hodhi krahëve një pelerinë-peshqir, gjeti automatikisht mbi dysheme pantoflat, por kur zgjati dorën të merrte celularin, tingujt u ndërprejnë. Ai lëshoi një psherëtimë. Po i hapej koka dhe këmbët mezi e mbanin. Pas pak, në dhomën e gjumit, zuri të

vishej përtueshëm. Tek vishej, e mblodhi të kthehej pa tjetër nga ambulanca e lagjes. Me apo pa librezë shëndetësore, do të shkonte t'i masnin tensionin. Nëse gjithë ajo këputje dhe dhimbje koke nuk i vinte nga tensioni, aq më mirë. Në një gjendje më të qetë, do të përpiquej të vendoste një farë rregulli brenda vetes. Pasi ta vendoste këtë rregull, do t'i duhej të merrte ca vendime.

I rigjallëruar disi ngaqë, sidoqoftë, mund të arsyetonte, një copë herë u kujdes për veshjen. Për atë ditë zgjodhi një kostum të zi. Një këmishë të bardhë dhe një kravatë të errët me pika të bardha. Mori në dorë çantën, një çantë e zezë prej lëkure, nga e cila nuk ndahej kurrë, hodhi krahëve pallton e madhe, gjithashtu të zezë, dhe, para se të dilte nga apartamenti, nuk harroi ta fuste celularin në xhepin e xhaketës. Për fat, ashensorin e gjeti të hapur pikërisht para apartamentit të tij, në katin e pestë. Ai u ngut përpara se dikush tjetër ta vinte në lëvizje. Kabina përshkoi qetësisht humnerën që vithisej poshtë dhe ndaloi në katin përdhes. Atje, me të dalë te shkallët e jashtme të pallatit, u zhyt në një banjë drite.

Përballë pallatit të tyre, ku ishin vendosur para një viti, ngriheshin shtatë garazhe tip, të parashikuara në kontratë me firmën ndërtuese qysh në projekt. Ata mbështeteshin te njëri-tjetri, ndaheshin nga një mur i brendshëm i përbashkët, mbuloheshin nga e njëjta çati prej betoni dhe të gjitha dyert, të hekurta, ishin lyer me të njëjtën ngjyrë, gri të errët, një ngjyrë e zymtë vërtet, por as ai, as pronarët e tjerë të garazheve, nuk kishin marrë mundimin ta ndryshonin.

Garazhi i tij ndodhej në mes. Ai vuri re se gjatë mungesës së tij dikush kishte vizatuar mbi derë me ngjyrë të kuqe një zemër të shpuar tej për tej me shigjetë. Në gjendje normale do të vinte buzën në gaz. Por koka vazhdonte t'i hapej dhe këmbët mezi e mbanin. Ai mendoi se duhej të shkonte sa më shpejt në ambulancë. Dhe nxori tufën e çelësave. Kur e futi çelësin e garazhit në bravë, u çlirua sinjali i celularit. Ai ngriu. Sytë i vajtën te zemra e shpuar me shigjetë dhe i hipi një zjarrmi. Për herë të parë qyshse celulari kishte filluar ta ngacmonte atë mëngjes me motivin e Fatit, mendoi se po e merrte në telefon vetë ai, Fati i tij, që i ishte shfaqur në trajtat e një gruaje me emrin Roksana, të cilën kujtonte se e kishte humbur përfundimisht në një kombinim fatkeq rrethanash.

Kësaj radhe reagimi i tij qe i menjëhershëm: la çantën përtokë. Me dorën e lirë nxori celularin nga xhepi dhe në ekran lexoi: Roksana. I ngazëllyer e vuri në vesh. Me dorën tjetër rrotulloi në bravë çelësin e garazhit. Arriti të shqiptonte fjalët “Po, Roksana”, tërhoqi dorezën e derës dhe nuk kuptoi asgjë. Ndjeu një buçimë, një gjëmim brenda kafkës.

Shpërthimi hipertensiv i trurit, mendoi. Dhe u përpi nga bota e hiçit.

2.

Zoti Sabit Kurti, inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Krimeve, - DPK, - i ngarkuar me mbulimin e ngjarjeve në kryeqytet, mezi i hapi sytë: e zgjoi mizorisht tringëllima e telefonit. Shifrat e kuqe të një radioje elektronike mbi komodinë, tregonin orën tetë e katër minuta. Sikur e shoqja të gjendej në krevat, e shtrirë pranë tij, zoti Kurti do t'i lutej ta kapte telefonin dhe kujtdo që të dilte t'i përgjigjej se bashkëshorti i saj nuk ndodhej në shtëpi. Mirëpo e shoqja e kishte lënë bosh vendin e saj në krevat prej kohësh. Drejtori i shkollës ku punonte qenkej i rreptë, nuk u falte as sekondën, u mbyllte derën, i linte jashtë, u priste ditën e punës për vonesën më të vogël dhe, në rrëmujën e mëngjesit, me dy linja autobusi, në rastin më të mirë asaj i duheshin të paktën dyzet minuta për të mbërritur.

Gjithnjë me sytë te shifrat e kuqe në ekranin e radios, inspektori e mori me mend se kush mund

ta kërkonte: njëri nga dy vartësit e tij, përkatësisht me pseudonimet Analisti dhe Zbavitësi. Personave në fjalë as që u shkante nëpërmend se eprori i tyre i mbiquante kështu dhe, po ta merrnin vesh, ka të ngjarë t'u mbetej hatri. Ç'është e vërteta, pseudonimet lidheshin me diçka vetjake të inspektorit: ata të dy i shihte si alter ego të tij. Pjesët e kundërta të vetvetes, të trupëzuara në trajtat e dy vartësve, ekzistencën e të cilëve e mbante tepër të fshehtë. Dhe bashkëpunimin me ta, të vetmen kënaqësi në një shërbim që po i neveritej çdo ditë e më shumë.

Analisti mbulonte rrethinat e kryeqytetit. Ishte tip i heshtur, hermetik, thoshte inspektori. Zbavitësi, perkundrazi, sillej i shkujdesur, herë-herë gati i papërgjegjshëm, dhe mbulonte kryeqytetin. Komunikimet midis tyre bëheshin me shkrim. Përpjekja për të futur kompjuterin mund të quhej e dështuar. Kompjuterat që u kishte vënë në përdorim kishin dalë jashtë loje pothuajse njëkohësisht, për të njëjtën arsye: ishin djegur. Në fillim ai i Zbavitësit. Një natë, rreth orës katër të mëngjesit, dikush kishte vjedhur pjesët e bakërta të transformatorit të bllokut ku banonte ai, duke shkaktuar një goditje katastrofike tensioni në rrjet, për rrjedhojë djegien e një numri të madh televizorësh, radiosh, kondicionerësh e kompjuterash. Sipas disave kjo duhej të ishte vepër e ndonjë personi që drogohej dhe i vidhte pjesët e bakërta për t'i shitur. Të tjerë akuzonin nën zë pronarin e laboratorit të riparim-shërbimeve për aparatura elektronike të zonës, i vetmi që përfitonte vërtet nga një mënxyrë e tillë. Gjithsesi, pas Zbavitësit, të njëjtën fatkeqësi e njoftoi edhe

Analisti. Në këto kushte, inspektori nuk mund t'u siguronte vartësive kompjutera sa herë u digjeshin. Ai iu kthye metodës tradicionale. Në depon e DPK-së zbuloi ca makina të vjetra "Olivetti" dhe qysh atëherë ata ia paraqisnin raportimet të daktilografuara. Në raste urgjencash e merrnin në telefon. Inspektori mbeti i befasuar kur në vend të ndonjërit prej tyre, në telefon i doli njeriu i fundit që priste ta merrte atë mëngjes: shefi i tij.

Një natë më parë ata kishin qëndruar bashkë kokë më kokë deri në orët e vogla. Në lokalin e hotelit "Pacifik", në një separe që e rezervonin të dielave në mbrëmje, larg syve të klientelës së zgjedhur, ata i kishin shteruar të gjitha bisedat. Prandaj ai u habit kur nga ana tjetër e fillit i erdhi zëri i shefit, i rëndë. Duket edhe atij ia kishte prishur gjumin dikush më lart në hierarkinë e DPK-së, e kjo do të thoshte se duhej të kishte ndodhur ndonjë nga ato të zakonshmet ngjarje të jashtëzakonshme.

Vetëm para nja dhjetë-pesëmbëdhjetë minutash, në zonën veriperëndimore të kryeqytetit, pranë vendit të quajtur "Shtatë garazhet", ishte kryer një atentat me bombë. Viktima qenkej një pedagog universiteti. Shefi shtoi se e shoqja e viktimës ishte shkrimtare e njohur, ndonëse nuk u tregua i sigurt për emrin: Ariana apo Adriana. Por mbiemrin ia mbante mend mirë, ai vetë kishte të njëjtin mbiemër, Gjini. Edhe një hollësi, sqaroi shefi para se t'i kërkonte të nisej urgjentisht: zonja Gjini është një grua shumë e bukur. Besoj të kesh lexuar ndonjë libër të saj.

Ai nuk kishte lexuar ndonjë libër të zonjës Gjini. Dhe nuk e kuptoi përse shefi gjeti rastin të vinte në dukje bukurinë e saj. Truri i tij u vu në lëvizje nga

diçka tjetër, pa lidhje me zonjën Gjini. Pa lidhje as me vetë viktimën. Përmendja e toponimisë më të re kryeqytetase “Shtatë garazhet” i erdhi e papritur. Inspektor Kurti e respektonte shefin. Mirëpo disa gjëra të zanatit nuk ndahen me askënd. Midis parimeve të kodit të tij, i pari ishte: mos i beso askujt. Dhe i dyti: ka të fshehta që nuk i zbulohen as shefit. Në këtë kategori futej edhe një dosje me titullin “Shtatë garazhet”, të cilën ai e kishte hapur para ca kohësh, i ndërgjegjshëm se po kryente një akt të kundërligjshëm dhe e ruante të kyçur në kasafortën e zyrës. Logjika prej profesionisti i sugjeroi të mos e pranonte thjesht si të rastit përputhjen e titullit të dosjes së tij përvëluese me toponiminë që kishte zgjedhur shefi për t’i saktësuar vendin e krimit. Po ç’lidhje mund të kishte atentati kundër një pedagogu të panjohur universiteti me dosjen “Shtatë garazhet”, pavarësisht se viktimë qenkej bashkëshort i një shkrimtareje të njohur, për më tepër, shumë të bukur?

Fill pas bisedës me shefin, telefoni tringëlli përsëri. Në anën tjetër i doli Zbavitësi. I dha të njëjtin informacion. Dhe priti ndonjë urdhër. Mos u lodh, ia ktheu i mërzitur inspektori. Do të shkoj vetë. Dhe përpiku të më njoftosh përpara se t’i marr vesh gjërat nga shefi.

Njëzet minuta më vonë, kur e parkoi makinën, një Benz ngjyrë blu, i tipit të vjetër, rrëzë pallatit dymbëdhjetë katësh të “Shtatë garazhet”, atë vazhdonte ta ngacmonte pyetja se ç’lidhje mund të kishte midis atentatit kundër profesorit të panjohur dhe dosjes së tij. Asnjë lidhje, mendoi. Dhe fiku

makinën. Tutje, para garazheve, sytë i zunë një furgon dhe vetura policie. Kureshtarë të shumë vazhdonin të rrinin aty rrotull. Dhe gazetarë. Në atë dekor shquante shefi i sapoemëruar i komisariatit numër trembëdhjetë, Sherif Daci. Koka e tij dilte sipër kokave të gazetarëve, të cilët e kishin vënë në mes dhe i drejtonin pyetje.

Ai zbriti nga makina me një dëshirë të vetme: të shkonte drejt të sapoemëruarit Daci. T'i hidhte prangat. Por kjo qe vetëm një ngasje. Kurti shpresonte që një çast i tillë, pra çasti kur do të provonte kënaqësinë t'ia hidhte prangat me dorën e vet atij njeriu, të vinte sa më shpejt. Duke menduar kështu, tek shkonte drejt garazheve, u përpoq t'i jepte vetes një pamje të qetë. Ai ia dilte gjithmonë t'i jepte fytyrës pamjen e dëshiruar. Ishte një heqje dhe vënie maskash, në një ballo të përhershme, ku aktorët e harronin fytyrën e vërtetë. Fytyra e vërtetë nuk u hynte në punë. Ajo po bëhej gjithnjë më e rrezikshme për vetë personin. Siç po bëhet për mua, mendoj kur u gjend pranë grupit të gazetarëve.

Shefi i sapoemëruar i komisariatit, i ngrëfësuar rëndshëm, mezi i nxirrte fjalët, duke i ndarë me ca “ë” të gjata, sipas shembullit të politikanëve. Inspektori Kurti nuk e pati në dorë të mos artikulonte brenda vetes fjalën “idiot”. Matanë shiritit rrethues të vendit të krimit, dy ekspertë vazhdonin të bënin matje. Njëri prej tyre, i ri në moshë, u shkëput, fshati që duket s'do kallauz, vërejt, gjithçka dëshmon për profesionistë. Mbi derën e garazhit gjetëm një shenjë, një zemër të shpuar tej për tej me shigjetë. Ndoshta për të orientuar ekzekutorët.

Inspektori qëndroi në hyrje të garazhit. Brenda gjendej një veturë e tipit “Peugot”. Më saktë, mbeturinat e një veture të deformuar krejt. Këndeje derës së shqyer nga shpërthimi, në vendin ku ishte shembur viktimja, hapej një pellg i madh gjaku. Eksperti i ri u ngut t’i sqaronte se viktimën e kishin nisur urgjent për në spital dhe tashmë ai ndodhej në sallën e operacionit, me fare pak shpresa shpëtimi. Inspektori tundi kokën automatikisht, pa i hequr sytë nga pellgu i gjakut. Dhe formuloi një pyetje që e befasoi ekspertin: ai deshi të dinte se cilët ishin pronarët e garazheve fqinjë. Tjetri ngriti supet. Inspektori e kuptoi, pyetja e tij kishte qenë pa vend. Dhe nuk lidhej me detyrat e ekspertit. Megjithatë iu lut të informohej me anë të ndonjë polici se si quheshin pronarët e garazheve ngjitur me garazhin e hedhur në erë të profesorit. Nga duar profesionistësh, mendoi pastaj, kur djaloshi u largua. Një bombë e aktivizuar me anë të një filli në çastin e tërheqjes së derës. I gjori profesor, ka tërhequr derën dhe bam! Po përse?

Ai u shty brenda garazhit, si të donte të gjente një përgjigje. Nuk mbante mend ndonjë atentat të tillë ndaj një universitari. Vite të shkuara, kur sapo ishte futur në shërbim, kishte ndodhur të vritej një pedagog, në mes të rrugës, i sulmuar natën me leva hekuri nga persona të panjohur, që nuk u zbuluan kurrë. Më pas kishte ndodhur të sulmohej një tjetër pedagog, kësaj radhe duke i hedhur acid sulfurik në fytyrë, vepër e një studenti të rrëzuar në provime. Njiheshin edhe raste më të lehta dhunimi, me rrahje, ja për shkak të rreptësisë së pedagogëve, ja për shkak femrash. Së fundi, tek shihte shefin e sapoemëruar Daci, që vazhdonte t’u përralliste

gazetarëve, atij i shkrepëtiu në tru një pyetje: çfarë po u përralliste gazetarëve ai njeri?

Pak a shumë e mësoi të nesërmen. Në mëngjes, me t'u futur në zyrë, zuri t'u hidhte një sy gazetave të ditës. Pothuajse të gjitha lajmin e atentatit e botonin në faqe të parë. Shumica e jepnin të shoqëruar me fotografinë e profesorit. Disa shtonin fotografinë e një gruaje. Të tjera, fotografinë e kolonelit Daci.

E qartë, tha ai me vete, pa pasur ndonjë gjë të qartë, përveç faktit që gruaja duhej të ishte bashkëshortja e viktimës, shkrimtarja Adriana Gjini. Dhe faktit tjetër që, pa dyshim, vlerësimi i shefit të tij sipas të cilit ajo ishte një grua e bukur, qëndronte. Për viktimën gazetarët duket nuk kishin mundur të siguronin ndonjë foto për të qenë. Të gjitha gazetat botonin të njëjtën foto, ku pozonte një burrë nja dyzet e pesë vjeç, në pamje ballore. Ai të vështronte në sy, siç të vështrojnë fytyrat e një fotoje standarte dokumenti, nga e cila nuk je në gjendje të kuptosh nëse personi që t'i ka ngulur sytë është debil i lindur apo një njeri që fshihet pas vështrimit të ngrirë. Përkundrazi, fotot e bashkëshortes së tij ishin të ndryshme, madje njëra nga gazetat botonte një fotografi të madhe të saj. Inspektorit nuk i pëlqeu ajo fotografi, sidomos vështrimi i gruas. Një vështrim sensual, i paturpshëm. Por më shumë se fotografia, nuk i pëlqeu diçka tjetër. Nuk e kuptoi pse gazetat shkrimet për atentatin në fjalë i shoqëronin me fotografinë e bashkëshortes së viktimës. Ndoshta, u përgjigj po vetë, sepse, siç thuhet, gruaja është një person publik. Një VIP. Gazetat mezi presin histori vipash, mendoi. Dhe sytë i vajtën te fotografia e kolonelit Daci.

Atij iu ngrit një e qeshur e hidhur. Njeriu i quajtur Sherif Daci, i sapoemëruar shef komisariati në vend të një ish-mikut të tij, vrarë në një atentat të bujshëm përpara dy muajsh, vuante së paku nga dy të meta: ai nuk i drejtohej kurrë me ju askujt. Dhe nuk i kërkonte falje kurrë, askujt. Kjo përkonte me diçka që e kishte lexuar në një revistë angleze, në artikullin e një gazetari investigues për jetën e një mafiozi shumë të kërkuar nga policitë e botës. Sipas gazetarit, krimineli në fjalë, ndër dyqind parimet e kodit të një mafiozi, të parin rendiste: mos iu drejto kurrë me ju askujt. Dhe të dytin: mos i kërko falje kurrë, askujt. Njerëzve të zakonshëm këto mund të mos u bënë përshtypje. Siç thuhet, s'mund të kërkoresh kaligrafi nga bytha e Argjirosë. Inspektori ishte gati të binte në një mendje me njerëzit e zakonshëm po të mos e vinte në dyshim nëse koloneli Daci e dinte kuptimin e shprehjes "Kaligrafi nga bytha e Argjirosë". Po ta dinte, ai ndoshta do të tregohej më i matur. Do ta kuptonte se ishte një gjurmë: gjurma që linte kudo, pa dashje ose qëllimisht, vetë Argjiroja.

Ashtu si stacionet televizive një natë më parë në kronikat për atentatin, gazetatat theksonin si për t'u tallur të njëjtin fakt: autorët e krimit ishin larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të paditur, pa lënë asnjë gjurmë, nëse nuk mund të quhej e tillë një makinë e bardhë e tipit Benz, të cilën e kishte parë në anë të rrugës matanë pallateve një banor, në orën katër të mëngjesit, tek kthehej me familjen nga një dasmë, e brenda saj sytë i kishin zënë dy persona të moshës së re. Policia kishte mbërritur menjëherë në vendin e ngjarjes, ku nuk kishte gjetur

asgjë, as ndonjë Benz të bardhë andej rrotull, përveç garazhit të hedhur në erë, makinës së shkatërruar të viktimës dhe vetë viktimën të mbytur në gjak. Ndër pistat më të mundshme: hakmarrja.

Zotit Kurti iu ngrit përsëri një e qeshur e hidhur. Kështu qoftë, mendoi, duke i shtyrë gazetën nënë. Argjiro, po e pranoj, siç kërkon të na mbushësh mendjen me anë të deklaratave të një polici rrugaç: motivi i atentatit kundër profesorit qenka hakmarrje. Profesorin e mjerë kushedi ç'mëkate e brenin. Dhe kur mëkaton gjendet gjithmonë një motiv për t'i dhënë shkas dikujt, ndonjë të çmenduri paranojak, të hakmerret. S'po përmend nëntekstet rreth një piste të mundshme që do të çonte te bashkëshortja e viktimës. Kësaj i thonë luftë mediatike dhe njerëzit janë mësuar të hanë çdo gjë. Pra, pse të mos hanë edhe legjendat që u servir ti me gojën e një polici rrugaç?

Inspektori mbështeti bërrylat mbi tryezë dhe shtrëngoi tëmthat. Prej dy muajsh, qyshse miku i tij kishte mbetur i vrarë bashkë me shoferin, po i ndodhte të fliste kështu. T'i drejtohej një fantazme, praninë e së cilës e ndiente me një konkretësi turbulluese. E përfytyronte të veshur me kostume dhe këmbisha elegante. Një xhongler. Një supermagjistër. Gjithçka e tij ishte e zgjedhur. Mjediset ku e kalonte kohën. Femrat. Pijet. Vrasësit e paguar. Maskarenjtë që bënin lojën e tij, çfarëdo qofshin, shtetarë, gazetarë a policë.

Ai e la tryezën dhe vajti pranë dritares. Jo larg ngrehinës së tyre të vjetër, që shërbente si seli e DPK-së, pamjen e zinin ca kulla të reja pesëmbëdhjetëkatëshe, të veshura me xham blu. Njëra dukej më e lartë për shkak të një mbulese në formë kupole.

Ai pati përshtypjen se nga kulla me kupolë po e vëzhgonin. Pastaj, tek kërkonte me sy për të gjetur se në ç'pikë mund të ishte vendosur vëzhguesi, pati një dridhmë. E përfytyroi tjetrin me dylbi dhe veten në fokus. Në rast se tjetri, me gjasë, po e fokusonte në tejqyrën e një arme, mjafton të tërhiqte këmbëzën dhe ai do ta merrte plumbin në ballë.

Jo, mendoi duke ngritur kokën, ai nuk ka ndonjë arsye ta bëjë këtë. Unë nuk e njoh, nuk di asgjë për të, pra nuk ka arsye të vendosë një snajper kundër meje. Qëndron atje, në Kupolë, si një perëndi e plotfuqishme prej nga vështron qytetin dhe na ka në këmbët e tij... Megjithatë, unë, vdekatar i rëndomtë, dyshoj përunjësisht: atentati i djeshëm kundër profesorit të historisë Platon Guri dhe atentati i dy muajve më parë, kur u vra i gori Akil, janë hallka të të njëjtit zinxhir. Në kasafortën e Akilit u gjendën ca shkresa të zakonshme dhe, për turp të Zotit, dy pako me prezervativë. Më bren kureshtja të mësoj se çfarë u vodh në atë kasafortë. Një dosje?

Për besë, Argjiro! Nga kasaforta e të ndjerit është zhdukur një dosje, nga ato që të hanë kokën. Njeriu që mbërriti i pari te kasaforta, – dyshoj po aq përunjësisht se duhet të ketë qenë polici yt rrugaç, – mori dosjen dhe, për të poshtëruar komisarin, në vend të saj la prezervativët. Veprim jo aq i mençur! Nga dëshira për t'u tallur, ai la një gjurmë që s'di pse më kujtoi një histori të vjetër me dy prostituta moldave. Atëherë qarkulloi poshtë e përpjetë sikur koloneli i paskej përdorur vajzat për aq kohë sa i mbajti të mbyllura në qytetin bregdetar ku drejtonte komisariatin. Tani, ca gjëra, edhe po të duash t'i kalosh, është e pamundur, të ngecin në

grykë. Kështu më ngeci edhe mua në grykë historia e përfolur e kolonelit. Dhe vura një bast me veten. Desha të sqaroja nëse akti i tij kishte qenë një akt i pastër prej vagabondi, apo fshihte edhe diçka tjetër. Ç'të zgjatem, Argjiro. Duke perifrazuar një shprehje të Napoleon Bonapartit, më doli se koloneli nuk ishte gjë tjetër veçse, pak a shumë, një copë m... i rrasur në prezervativ.

Ai iu largua dritares. Intuita i thoshte të shkonte te shefi, t'i parashtronte teorinë e tij. Një argument i ri befasues i përforconte të gjitha dyshimet e mëparshme. Platon Guri kishte ikur bedel, për dhjamë qeni, siç thuhet. Për fatin e keq të profesorit, garazhi i tij ndodhej ngjitur me garazhin e një personi tjetër, banues në të njëjtin pallat, i njohur si Bosi i kozmetikave. Këtë individ inspektori e kishte në skedat e tij me emrin e koduar Parfumi. Atentati synonte Parfumin. Shenja të shumta dëshmonin se ky po i fuste hundët në zonat e drogës. Atje Argjiroja nuk të falte. Stili dhe egërsia e atentatit të çonin tek ai. Mirëpo gjithçka ishte bërë lëmsh nga gabimi trashanik i ekzekutorëve. Argjiroja duhej të ndihej i sëkëlldisur, në mos i tërbuar nga inati: ca debilë i kishin prishur punë, i kishin hapur një telash fare të kotë. Po kush dreqin është Argjiroja, do të pyeste shefi po t'ia parashtronte teorinë e tij e në këtë pikë gjërat ndërlikoheshin.

I mërzhitur, zoti Kurti zuri vend përsëri në tryezë dhe nxori nga sirtari një fletë të bardhë. Kur ndihej bosh ai shkarraviste mbi një copë letër të bardhë. Atë ditë, pa e kuptuar, zuri të vizatonte trupin e një qenieje gjarpërore, me dy putra të mëdha dhe qafën. Mendoi se tek ajo qafë degëzoheshin disa koka. I

përqendruar, të thuash se vizatimin do t'ia paraqiste ndonjë jurie, sajoi kokën e parë: një rreth të vogël. Brenda rrethit, midis dy pikave, një vizë të shkurtër vertikale, poshtë saj, një vizë edhe më të shkurtër, horizontale. Në të vërtetë, tha me vete, Sherif Dacit do t'i shkonte më shumë një kokë penisi. Por iu duk disi e padenjë të vizatonte një kokë penisi. Kështu që u mjaftua me rrethin e vogël, ku shtoi flokët dhe veshët konvencionalë.

Si mbaroi me Sherif Dacin, inspektori ndau nga qafa-trung degëzimin e dytë. Një copë herë u rrek të përfytyronte se çfarë do t'i përgjigjej më besnikërisht paraqitjes simbolike të kokës së personazhit të dytë, të cilin e kishte në dosje me emrin e koduar Perla. Sigurisht, edhe Perlës do t'i shkonte për bukuri një kokë penisi. Por meqë ky ushtronte detyrën e ministrit, pra në pikëpamje të hierarkisë qëndronte ca shkallë më lart se koloneli dhe, sidoqoftë, zotëronte një tru më cilësor, që e pajiste së paku me aftësinë për t'u ruajtur, një kokë penisi e thjeshtë nuk do të mjaftonte. Perlës do t'i përshtatej simbolikisht, për shembull, një kokë penisi e mbështjellë në prezervativ. Inspektori u orvat seriozisht të sajonte një kokë penisi të mbështjellë në prezervativ dhe, në njëfarë mënyre, ia doli. I nxitur nga ky sukses, pak më sipër ministrit ai nxori një degëzim të tretë. Me të njëjtin durim vizatoi një tjetër kokë penisi mbështjellë në prezervativ e kjo i përkiste figurës ndoshta më enigmatike të dosjes së tij, deputet dhe funksionar i një partie politike, me emrin e koduar Dreri. Së fundi nxori një degëzim të katërt, por nuk u ngut ta plotësonte me ndonjë kokë-penis. Në vend të kësaj skicoi një katërkëndësh të madh dhe brenda

katërkëndëshit shkruajti fjalën LAURA. Ky nuk ishte emër i koduar. Ishte emri i vërtetë i një kompleksi disa kilometra larg kryeqytetit, një lloj perandorie qejfi, pronari i së cilës, i dyshuar për afëra të pista, përflitej jo rrallë nga shtypi si person i kërkuar nga drejtësia e një shteti të huaj.

Unë jam nëpunës i shtetit tim, mendoi inspektori dhe i hodhi një vështrim qenies gjarpërore. Duke qenë nëpunës i shtetit tim, e vazhdoi arsyetimin i pakënaqur nga shkarravina, nuk më takon të fus hundët në punët e të tjerëve, kërkohen apo nuk kërkohen nga një shtet i huaj. Kjo nuk hyn në kompetencat e mia. Aq më pak kam të drejtë të skedoj e të mbledh të dhëna për njerëz me imunitet parlamentar.

Ai e mori shkarravinën, i vuri zjarrin në flakën e një çakmaku dhe e mbajti në dorë derisa i përcëlloi gishtërinjtë. Teorinë time shefi do ta quajë të fandaksur, mendoi, ndërsa mua do të më këshillojë të shkoj të vizitohem te ndonjë mjek psikiatër. Me të drejtë, përderisa nuk jam në gjendje t'ia hap petat lakrorit. Ato që di unë, sado skandaloze, s'mund të shërbejnë si fakte, një jurist i shkathët do t'i rrëzonte me lehtësi dhe kokat-penis, me ose pa prezervativ, të dosjes sime, nuk e kanë të vështirë të gjejnë sa dhe kur të duan juristë të shkathët. Tekefundit, ç'më duhet mua, përse të hap telashe që nuk i do njeri?

Ky arsyetim i ngjalli një ndjesi të pështirë, sikur dikush po e posedonte seksualisht. Prej kohësh, atë po e gërryente gjithnjë e më shpesh kjo ndjesi. Dhe bashkë me të ideja e rebelimit. Ai nuk mund të pranonte të ndihej përjetësisht i tredhur. Me raste, si atë ditë, ideja e rebelimit të tij shkonte larg. Fjala vjen, të kryente një veprim jo aq serioz: të jepte

dorëheqjen. Pa bujë. Ashtu siç ishte futur rreth trembëdhjetë vjet të shkuara në këtë lloj shërbimi, në mënyrë disi aventureske, pas përfundimit të studimeve të larta në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega matematikë. Shkaktar që ai të ëndërronte ta braktiste profesionin ende pa e filluar ishte bërë dikur, në vitet studentore, një serial i gjatë televiziv me Sherlock Holmes-in.

Të nesërmen e mblodhi t'i përgatiste shefit një raport formal për atentatin dhe t'i lutej t'i jepte një leje të shkurtër. Gjatë ditëve të lejes do të mund të peshonte seriozisht variantin jo aq serioz të dorëheqjes. Ndoshta pas trembëdhjetë vjetësh shërbimi gjendej në pragun e provës, e ballafaqimit me veten: të vazhdonte më tej, apo t'i kthehej matematikës.

Nuk arriti as të shkruante raportin, as t'i kërkonte shefit ndonjë leje. Në orën dhjetë e tridhjetë minuta, si kishte hedhur e fshirë në kompjuter dy variante të raportit, përmes celularit i mbërriti një telefonatë. Kësaj radhe i doli Analisti. E njoftoi për një vrasje, diku nga Kopshti Botanik. Disa kalimtarë kishin hasur në anë të rrugës një veturë. Brenda saj, te vendi i shoferit, një person të vrarë. Inspektorit iu ngrit mendja kur, për forcë zakoni, pyeti e ç'tipi ishte vetura dhe Analisti iu përgjigj: një Benz i bardhë.

Ai e mbylli celularin, e futi në xhepin e xhakëtës. Po të pranojmë se Benz-i i bardhë është vetura për të cilën ka dëshmuar banori dasmor i pallatit, atëherë... Inspektori ktheu kokën dhe vështroi nga Kupola. Atëherë ti po ngutesh të zhdukësh gjurmët, Argjiro. Mirëpo dasmori ka parë në veturë dy persona. Pra, kam të drejtë të pyes: cila do të jetë viktima e radhës?

3.

Mua më duan të vdekur. E bëj këtë deklarë sot, e enjte, 16 janar 2003, ora 14⁰⁰. Unë nuk e di kush janë ata që më duan të vdekur, por arsyen e kam të qartë: jam ngatërruar me një vrasje. Prandaj jam i detyruar të fshihem. Dhe të lë këtë dëshmi.

Nuk kam asnjë ide ku ndodhem, cilët janë ata që më fshehin. I vetmi njeri që di diçka për mua është vëllai im i madh, Marku. Duke gjykuar nga kushtet ku ndodhem, druaj se edhe ai nuk di hollësisë, përveç faktit që jam në duar profesionistësh. Për të më shpëtuar, u paguam qimet e kokës. Këstin e dytë të parave do ta marrin nga im vëlla pasi të më nxjerrin matanë kufijve.

Kur u ndamë, Marku vazhdonte të ishte tërë nerva. Njerëzit e shtëpisë, fëmijë e të rritur, ishin mbyllur nëpër dhoma, bënë sikur flinin. Por asnjëri nuk flinte. Ata përgjonin me veshët përpjetë për të

kapur edhe zhurmën më të vogël. Siç përgjoja edhe unë me Markun. Për të dhënë përshtypjen se jeta te ne rridhte normalisht, ishte lënë hapur vetëm një dritë, ajo e një dhome ku ai mbyllej netëve. Të tjerat ishin fikur. Kështu që edhe ne të dy po rrinim në errësirë, në katin përdhes, pranë derës së jashtme. Mua do të vinin të më merrnin në orën dymbëdhjetë të natës. Sinjali i njohjes: tri trokitje në derën e jashtme. Për çdo rast, Marku ishte i armatosur me revolver.

Në fillim unë nuk e kuptova rrezikun që më kanosej. Në fillim unë e mbajta gjithçka të fshehtë, madje Markut nuk i tregova gjë edhe kur kanalet televizive dhanë lajmin e një atentati me bombë kundër një profesori. Unë as që dyshova se isha ngatërruar në atë atentat. Fillova të dyshoja disi kur mikun tim të vjetër Altinin nuk po ma zinin sytë. Dhe u tmerrova kur të pasnesërmen e krimit, pra dje, në qytezë u hap lajmi se Altini ishte gjetur i vrarë në makinën e tij, diku nga zona e Kopshtit Botanik në Tiranë. Këtë lajm e mësova nga Klodi: motra e Altinit dhe e fejuara ime. Ajo më mori në telefon. Nëse je ngatërruar me Altinin, më tha duke qarë, bën mirë të zhdukesh sa më shpejt. Mos të të shkojë mendja të vish të më takosh ose të më marrësh në telefon. Ik një orë e më parë, kaq të them. Dhe mbylli celularin. Ndodhesha në klub. Ishte ora tre pasdite dhe vajta drejt e në shtëpi. Markun e gjeta duke ngrënë. Pas rrëfimit tim atij i mbeti buka në fyt. I tërbuar nga inati, më dha një flakërimë turinjve me sa i hëngri krahu. Nuk lëshova as gëk, as mëk.

Në orën dymbëdhjetë të natës, në rrugën përpara shtëpisë, ndaloi një makinë. Në derë u ndien tri

trokitje të lehta dhe ne u qetësua. Marku tërhoqi shulin, doli jashtë dhe për disa çaste unë mbeta në errësirë, me një çantë të mbushur me plaçka, të cilën e mora në dorë sapo dëgjova zërin e tij që më urdhëroi të dilja.

U ndamë pa ndonjë ceremoni. Ai nuk më përqafoi. Vetëm më porositi t'u bindesha për çdo gjë të panjohurve. Unë tunda kokën, pa e kuptuar mirëfilli ç'po ndodhte. Gjithçka po më dukej lojë. Kjo përshtypje nuk m'u shqit as kur zura vend në ndenjësën e prapme të makinës dhe para se ajo të nisej, pata kohë t'i hidhja një vështrim e t'ia bëja me dorë Markut. Për shkak të errësirës, ky nuk e vuri re përshtendjet time. Atëherë makina u nis dhe njëri nga të panjohurit, që ishte ulur pranë meje, më dha porosinë e parë: po të na dalë policia, të tregohesh i qetë. Jemi kushërinj, po kthehemi nga Tirana, ku ishim për lidhjen e një fejese. Pastaj, si përshtkua një pjesë të autostradës, erdhi kërkesa e dytë. Me t'u shmangur autostradës, po ai person më shpjegoi se, sipas marrëveshjes, rrugën e mbetur deri në vendin ku do të mbërrinim, duhej ta bëja me sy të lidhur. Kjo kërkesë m'u duk e tepërt. Unë edhe me sy të palidhur tashmë nuk po orientoheja dot.

Ndjesinë e një njeriu të dënuar me vdekje e provova sapo i panjohuri m'i lidhi sytë me një fashë të zezë. Të dënuarit me vdekje kështu i dërgojnë para togës së pushkatimit, mendova, symbyllur. Dhe nuk m'u duk çudi që, ca më tej, i panjohuri pranë meje, po ndoshta ai që rrinte i heshtur në ndenjësën përpara, të nxirrte një pistoletë. Të ma vinte në lule të ballit, të më çonte atje ku kishin çuar Altinin.

Më mbuluan djersë të ftohta. Gati po e besoja se makina do të ndalej anës rrugës. Të panjohurit do të më këpusnin një plumb në zverk dhe ashtu, sylidhur, do të më flaknin gjëkundi brenda ndonjë kanali. Por makina nuk ndaloi dhe mua nuk më flakën në ndonjë kanal. Pata vetëm një përshtypje të fortë sikur pranë meje, në vend të të panjohurit, erdhi e qëndroi Altini. Kjo ndodhi kur makina kërceu në një gropë dhe ne u shkundëm të gjithë. Rrugë fshati, tha Altini me zë të ulët. Unë nuk shfaqta ndonjë mendim. Që kjo ishte një rrugë fshati kuptohej pa qenë nevoja të ma shpjegonte njeri, aq më pak Altini. Mos u tut, deshi të më jepte zemër ai. Mua më vranë pabesisht, nga prapa, me një plumb në zverk. Po të kishin ndërmend të të vrisnin, siç më vranë mua, tani ti duhej të ndodheshe në ndenjësen përpara dhe plumbin do ta haje në zverk, nga prapa. Nuk është ndonjë gjë e madhe. Pastaj kjo pritej, apo jo! Të gjithë e kishin parashikuar këtë fund për mua. Të gjithë thoshin se një ditë trupin tim do ta gjenin të bërë shoshë, ndërsa mua më dhanë vetëm një plumb. Pra, të gjithë u gabuan.

Qesha. Që të mos qaja. Dhe lëshova një psherëtimë kur i panjohuri pranë meje tha: mbërritëm. U dëgjua e lehura e egër e një qeni. Unë shpresova që më në fund të m'i zgjidhnin sytë, por nuk ndodhi kështu. Zbrita nga makina gjithnjë me sytë mbyllur. Dhe gjithnjë i shoqëruar nga i panjohuri, që kishte qëndruar me mua në ndenjësen prapa. Hapësira mbante era tym. Nën të lehurat e qenit, duke thithur ajrin e lagësht të natës ngarkuar me tym, ngjita ca shkallë. U hap një derë, u futëm brenda. Për disa çaste mbeta në këmbë duke dëgjuar bisedën me zë

të ulët të dy personave, pa kuptuar asgjë. Kuptova vetëm se po kaloja nga një palë duar, në duar të tjera. Derisa përfundova në dhomën ku gjendem i mbyllur tani. Dhe më zgjidhën sytë.

I panjohuri që më kishte shoqëruar, ishte zhdukur. Para meje ndodhej një i panjohur tjetër. Shtatmesatar, rreth të pesëdhjetave, me tipare të hequra, me një mjekër të parruar, ai nuk më ngjalli kurrfarë besimi. Megjithëse, për ironi, tha se e quanin Besim dhe do të kujdesej për mua për aq ditë sa do të qëndroja atje. Dhe më sqaroi rregulloren e brendshme. Siç ua kishte sqaruar plot të tjerëve, që kishin kaluar nëpër duart e tij përpara meje. Këtë të fundit e theksoi. Pra, ndalohej rreptësisht të kryeja veprime që mund të tradhtonin praninë time atje. Fjala vjen, nëse pija duhan nuk duhej t'i flakja bishtat e cigareve jashtë, përmes dritares. Nevojat vetjake do t'i kryeja në kthinën ngjitur, një banjë alla frënga, me lavaman dhe një pasqyrë të vendosur mbi mur, sipër rubinetit të çezmës. Ai më shpjegoi edhe plot hollësi të tjera të rregullores. Të thuash se gjatë ditëve të qëndrimit tim atje veten duhej ta quaja të burgosur dhe atë një lloj gardiani. Më erdhi ta kapja për fyti, ta flakja nga dritarja. Mirëpo dhoma nuk kishte dritare. Ajo që ai e kishte quajtur dritare, përmes së cilës unë nuk duhej t'i hidhja bishtat e cigareve, ishte një frëngji e ngushtë afër tavanit. Vëreja gjithashtu se ajo nuk shihte fare jashtë, shihte në një lloj oxhaku të brendshëm ajrimi, e në këtë pikëpamje dhoma ku ndodhesha ishte krejt e izoluar. Së fundi, për të saktësuar përfundimisht statusin tim, ai më kërkoi t'i dorëzoja celularin, nëse më ndodhej një i tillë. I thashë se nuk më

ndodhej. I thashë se, sipas marrëveshjes me ata që më kishin dorëzuar tek ai, gjatë qëndrimit këtu më ndalohej përdorimi i celularit, pra mund të rrinte i qetë. Megjithatë ai më paralajmëroi solemnisht: gjëja më e rrezikshme për mua tani do të ishin llafet e tepërta. Në këtë botë, vërejtje, ndonjëherë gjëma të vjen andej nga nuk e pret.

Konstatim i vërtetë. Ndoshta kjo më bëri t'i drejtohesha me një kërkesë të çuditshme. Të ndërmjetësonte që Marku të më dërgonte një kasetofon dhe disa kaseta me muzikë. Ai më vështroi i hutuar. Duket askush përpara meje nuk i ishte drejtuar me një kërkesë të tillë. E dua të shtyj kohën, i thashë, të vras mërzinë. Ai vazhdoi të më shihte dyshimtar. Ose nuk e dinte ç'është një kasetofon, ose e kishte nuhatur qëllimin tim. U largua heshturazi. Mbylli derën pas vetes, e mbylli edhe nga jashtë me çelës. Unë mbeta në dhomën e zhveshur: një krevat, një komodinë, një karrige. M'u duk e përbindshme që s'mund të komunikoja dot së paku me Klodin. Dhe rashë përmbys mbi krevat. Jam një i dënuar me vdekje, mendova.

Nuk e kam të qartë pse po e lë këtë dëshmi, kujt ia drejtoj. Që në çastin kur i kërkoja gardianit tim të ndërmjetësonte te Marku për kasetofonin, e ndieva se kisha mbërritur në një pikë të pakthyeshme të jetës. Në atë cak ku kthimi prapa është i pamundur dhe përtej s'dihet ç'të pret. Për më se dymbëdhjetë orë, derisa gardiani im i zyrtë më solli kasetofonin bashkë me disa kaseta, isha në gjendjen e një shterimi të skajshëm nervor. Me ngasje vetëvrasëse: të përplasja kokën pas murit, të prisja damarët e

duarve. Mirëpo unë s'mund ta pranoja idenë të ikja kështu duke marrë mbi vete barrën e një faji të pakryer. Ndonëse nuk jam i sigurt nëse kjo dëshmi do të bjerë në duar njerëzore, pra në duar qeniesh që vazhdojnë ta ruajnë njerzillëkun, apo në duart e atyre që më duan të vdekur. Po ta pranoj këtë mundësi të dytë, do të thotë të pranoj se më parë do të jem vrrarë prej tyre. Në një rast të tillë nuk do të përmbysset bota. Unë jam një njeri i rëndomtë, një anonim. Dhe i përkas asaj kategorie shtetasish që te ne shpesh i cilësojnë me nofkën “çeçenë”. Ç’t’i bësh, nuk është faji im për këtë idiotësi raciste të bashkëkombasve të mi.

I pari që e përdori ndaj meje nofkën “çeçen” ka qenë Altini. Atëherë unë nuk e dija çfarë ishte Çeçenia, nga binte dhe përse cilësimi “çeçen” ishte një nofkë fyese. Kur Altini më tha “çeçen”, duke e marrë me mend se kjo duhej të ishte diçka e keqe, unë ia ktheva “çeçen je vetë”. Altini u tall. Unë kam lindur këtu, vërejt, s’ka si të jem çeçen. Çeçenë jeni ju, që keni ardhur nga vende ku ha pula gurë dhe njerëzit flenë shpellave. Protestova. Kisha ardhur nga një vend ku pula nuk hante gurë dhe njerëzit nuk flinin shpellave. Megjithatë, meqë kishte lindur në qytezë, Altini mbahej se i përkiste një race më të fisme. I ziu Altin!

Kërkoj ndjesë për ndërprerjen e detyruar të incizimit. Besimi, zymtësia e të cilit më tremb, më solli për të ngrënë. Një sanduiç dhe një birrë “Amstel” me kanoçe. Tek përtypesha dëgjova zërin tim të incizuar. Nuk desha ta besoja se ishte zëri im, aq i huaj m’u duk.

Isha, pra, vetëm katërmbëdhjetë vjeç kur mbërrita në këtë vend që edhe sot e kësaj dite, bashkëkombas të mi vazhdojnë ta quajnë Çeçeni. Për t'i bërë qejfin kësaj kategorie, edhe unë kështu po e quaj, Çeçeni. Tashmë kjo s'më sjell kurrfarë kompleksi. Aq më bën si më quajnë, çeçen, eskimez apo zulu.

Dikur nofka “çeçen” më bënte të vuaja. As Çeçenia nuk ishte kjo që është sot: një amebë e stërmadhe. Në fillim Çeçenia pluskoi në zonën kodrinore, zuri ta gllabëronte centimetër pas centimetri. Më tej u shtri nga lindja, u shtri edhe nga perëndimi, jugu e veriu. U var poshtë, në të gjithë gjatësinë e bregut të lumit, u përzie me ngulimet e romëve, përparoi drejt rrugës automobilistike, deri buzë saj, ku futi brenda vetes pallatet e vjetra.

Me të lënë prapa urën e lumit njerëzit kanë rastin të sodisin nga dritaret e automjeteve shfaqjen indiferente të Çeçenisë: një pafundësi shtëpish rrëzë njëra-tjetrës, në sfondin e të cilave shquhen ca vila të rrethuara me mure të lartë. Vjen pastaj pjesa më mbresëlënëse. Rruga automobilistike merr një kthesë të fortë dhe shtrëngohet në të dy anët midis vargut të gjatë të dyqaneve të ngritur pa kurrfarë rregulli, njëri më i shëmtuar se tjetri, ku ekspozohen mallra të tregut global, të çdo cilësie, me një kolorit tepër ekzotik. Në verë, nën pluhurin që ngrejnë makinat e që varet pezull nga mëngjesi në mbrëmje. Në dimër, pranë baltës dhe pellgjeve me ujë. Dhe, doemos, dimër, verë, duke anashkaluar pirgje plehrash. Këtij dekori i jep dorën e fundit era e përhershme që fryn nga gryka e lumit. Ajo rrëmben copëra letrash, qese plastmasi, lloj-lloj leckurinash dhe zbukuron me to drurët e rrallë.

Shtëpia ku unë kam banuar dhjetë vitet e fundit ndodhet në një pikë të trupit të amebës. Tani ajo nuk bie në sy. Por dhjetë vjet të shkuara, kur Marku kishte ndërtuar vetëm katin e parë të saj mbi një truall për të cilin ai ka dokumente që dëshmojnë se ia ka blerë pronarit të ligjshëm të tokës, ajo dallohej që larg. Përreth kishte pak shtëpi. Përreth kishte më shumë gropa. Ditë e natë mbërrinin njerëz që hapnin gropa, hidhnin themele, në një rrëmujë që s'merrej vesh ç'bëhej. Çeçenia i ngjante një Far West-i. Drejt saj dyndeshin të gjithë, në kërkim të një Eldoradoje. Të gjithë braktisnin viset e lindjes ku kishin qenë të mbyllur gjithë jetën në një regjim getoje. Tani, befas, gjithçka ishte bërë e mundshme. Të shkoje ku të doje, të vendoseshe ku të doje, mjafton të kishe pak guxim, pak shpirt aventure. Dhe ca para. Nëse nuk i mblidhje dot aq para sa të blije një truall, punë e madhe, trualli pushtohej. Unë mbërrita në Çeçeni pikërisht në atë epokë Far West-i, në një ditë të nxehtë korriku të vitit 1993.

Nuk mbërrita në kërkim të ndonjë Eldoradoje. Atëherë unë nuk e kisha dëgjuar ende fjalën Eldorado dhe më vonë, kur e mësova, u ndjeva i sigurt së paku për një gjë: Eldoradon nuk do ta kisha përfytyruar në trajtat e Çeçenisë. Unë mbërrita atje një pasdite të nxehtë korriku sepse kështu kishin vendosur të tjerët. Jam më i vogli i një familjeje me gjashtë fëmijë, një motër tashmë të martuar, dhe pesë vëllezër. Dy nga këta prej kohësh kishin ikur refugjatë, njëri në Angli, tjetri në Greqi. Një i tretë ka mbetur në fshat, bashkë me të dhe nëna. Më i madhi, Marku, zgjodhi Çeçeninë. Pas vdekjes së tim eti, kur sapo kisha mbushur katër vjeç, Marku ka

qenë për mua në vend të babait. Dhe fjala e tij, ligj. Marku dhe vëllezërit vendosën që unë të shkoja me të në Çeçeni. Kështu do të mund të realizohej porosia e fundit e atit tonë të ndjerë. Sipas tyre, para se të vdiste, ai u paskej lënë një amanet: të bënin çmos që unë, fëmija më i vogël, të shkollohesha, të ndiqja studime të larta. Plaku paskej parashikuar madje edhe profesionin tim të ardhshëm: mjek. Doktor me diplomë shtetërore! Më vjen keq. Siç erdhën punët, amaneti i plakut nuk u plotësua dhe, me gjasë, nuk do të plotësohet kurrë. Jo për faj të vëllezërve. Ata kanë bërë shumë për mua. Fjala vjen, sa herë që zbriste në qytet, Marku më sillte libra. Më kujtohet njëri prej tyre: “Doktor Dulitlli”. Më kujtohet dhe një i dytë: “Aventurat e baronit Mynhauzen”. Të parin Marku duhet ta ketë blerë me siguri sepse bëhej fjalë për një doktor. Të dytin, ndoshta jo aq për aventurat se sa për protagonistin e tyre baron, emri i të cilit tingëllonte qartë si gjerman dhe Marku kishte nderim për disiplinën gjermane. Sidoqoftë, amaneti i plakut nuk u realizua dhe më mbetet të pohoj se fajin e kam vetë. Ndoshta për shkak të një fataliteti, apo një kombinimi fatkeq të yjeve ditën e lindjes sime, më ka ndodhur shpesh të gjendem në vendin e gabuar, në çastin e gabuar. Nëse diçka e tillë mund të quhet faj.

Në fillimet e Far West-it tim unë nuk isha i aftë të realizoja arsyetime kaq të holla. Punët për mua paraqiteshin më të thjeshta. Me gjithë përkujdesjet e Markut dhe gruas së tij, në Çeçeni mërzhitesha për vdekje. Tërë ditën e kaloja me fëmijët e vegjël të tim vëllai, një vajzë dhe një djalë, përkatësisht pesë dhe tre vjeç. I doja shumë, vërtet, por nuk është ndonjë

kënaqësi të merresh nga mëngjesi në mbrëmje me kalamaj. Do t'ia kisha dalë t'ia mbushja mendjen Markut të më lejonte të kthehesha në fshat, e kjo do të kishte qenë një zgjidhje e lumtur për të dy. Mirëpo tashmë gjithçka ishte paravendosur: unë gjendesha në një rrugë pa kthim. Dhe Altini, njeriu i parë që do të ndeshja.

Njohjen tonë e mbaj mend mirë. Ka qenë shtator, dita e hapjes së shkollës. Marku i kishte kryer të gjitha formalitetet e regjistrimit dhe mua s'më mbetej gjë tjetër veç të paraqitesha: hyja në klasën e tetë. Shkolla ishte një godinë dykatëshe me mure të pasuvatuar, xhama të thyer dhe çati të mbuluar me tjegulla. Ajo ndodhej matanë rrugës automobilistike, në pjesën fushore të qytezës ku banorët ishin të vjetër dhe, në përgjithësi, e mbanin veten për kryeqytetas.

Nuk më kujtohet për ç'arsye, në klasën ku figuronte i regjistruar emri im, unë u paraqita me vonesë, ora e parë kishte nisur. Më kujtohet një hollësi. Kur shtyva derën dhe hyra brenda, mbeta i hutuar nga vështrimi i një mësuesi. Ca më shumë nga dyzet palë sy, që u përqendruan mbi mua. Mësuesi më pyeti ç'kërkoja dhe unë i shpjegova ç'kërkoja. Atëherë, midis të qeshurave të shkaktuara nga dialekti im, ai më pyeti si quhesha e nga vija. U ndjeva sikur po rrija në këmbë lakuriq. Gjithmonë nën vështrimin e dyzet palë syve, shqiptova emrin: Erald. Dhe mbiemrin: Perjaku. M'u duk e tepërt të sqaroja nga vija, në rrethanën e dhënë kjo s'kishte rëndësi. Burri uli kokën mbi regjistër. Pastaj e ngriti, më hodhi një vështrim nga poshtë lart, tha po, emri

yt figuron, pra mund të zija vend bashkë me të tjerët.

Klasa ishte e mbushur plot. E vetmja bankë me një vend të lirë gjendej në të djathtë, në fund të rreshtit, nga ana e dritareve. Atje më priti pa ndonjë entuziazëm një djalë i heshtur. Ky ka qenë çasti kur rruga ime u kryqëzua me atë të Altinit. Siç shihet, nuk ka qenë as çast i gabuar, as vend i gabuar. U ula pranë tij dhe sajova një buzëqeshje. Ai nuk ma ktheu me të njëjtën monedhë. Ai e gjykoi të mundshme të më drejtonte një buzëqeshje pa ngjyrë të nesërmen, kur e kuptuam të dy se, donim apo nuk donim, nuk do të kishim një zgjidhje tjetër më të mirë: ishim të detyruar të rrinim në një bankë.

Sa për sqarim: më poshtë nuk dua të krijoj përshtypjen sikur njohja me Altinin ka qenë për mua ngjarja fatale e jetës. Më ka ngjallur gjithmonë neveri ky mendim. Të gjithë më thoshin të largohesha prej tij, herët a vonë ai do të përfundonte keq. Nuk e kam kuptuar kurrë përse njerëzit tregoheshin kaq shpirtvegjël. Të thuash se unë isha qingji i pafajshëm, ndërsa Altini ujku që do të më shqyente. Të thuash se ata mezi prisnin që profecia e tyre të vërtetohej dhe tani që ajo u vërtetua, që Altini u gjet me një plumb në zverk, ndihen të kënaqur. Dhe unë duhet t'u bie në gjunjë, t'u puth duart, t'u shfaq pendesën time. Po e them një herë e mirë: nuk kam ndërmend t'i bie në gjunjë askujt. Aq më pak të puth ndonjë dorë, apo të shfaq pendesë. Më vjen për të vjellë...

Po ndoshta fajin që tani më vjen për të vjellë e ka sanduiçi i Besimit. Ose birra "Amstel" me kanoçe. Sanduiçi, ose birra, ose të dyja bashkë, duhet të kenë qenë të skaduara. Tekefundit, kaq